



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA E MBROJTJES , PËRFSHIRJES DHE STREHIMIT SOCIAL
SEKTORI I STREHIMIT SOCIAL

PROJEKTVENDIM

Nr. 4 datë 14.6.2024

“Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë në tregun e lirë për vitin 2024, për familjet që përfitojnë subvencionin e qirasë në tregun e lirë, sipas strukturave përkatëse të banesave”

Në zbatim të ligjit nr 22/2018 “Për strehimin social”, kreu V neni 33,34,35,38,39 dhe të VKM nr 362, datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij”. Sipas relacionit të grupit të punës, Kryetari i Bashkisë Vau Dejës i propozon Këshillit Bashkiak Vau Dejës të :

VENDOSI

1. Miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë në tregun e lirë, për familjet që përfitojnë subvencionin e qirasë në tregun e lirë, sipas strukturave përkatëse të banesave (bashkëngjitur gjeni relacionin)
2. Ngarkohet për zbatimin e tij Sektori i Srehimit Social.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 të Ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

**KRYETAR
KRISTIAN SHKRELI**

Në mungesë dhe me urdhër

ZV/KRYETARI

Aleksandra Gjoni



Konceptoi:
Specialist Strehimit Social
Edmond Gjeçaj

Miratoi:
Përgjegjëse Sektori Strehimit Social
Bleona Shimaj

Konfirmoj Bazën Ligjore:
Ersilda Preka



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA E MBROJTJES, KUJDESIT DHE PËRFSHIRJES SOCIALE
SEKTORI I STREHIMIT SOCIAL

Nr. _____ prot.

Vau Dejës, më 14, 6, 2024

RELACION

Mbështetur në nenin 38, pika 1, e ligjit 22/2018 "Për strehimin Social", në urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr. 414 datë 11.06.2024 "Për ngritjen e grupit të punës për nxjerrjen e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë në tregun e lirë, për familjet që përfitojnë subvencionin e qirasë në tregun e lirë, sipas strukturave përkatëse të banesave", si dhe relacionit të grupit të punës me nr. ____ datë 14.06.2024, me Lëndë : Informacion për ngritjen e grupit të punës për nxjerrjen e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë në tregun e lirë, për familjet që përfitojnë subvencionin e qirasë në tregun e lirë, sipas strukturave përkatëse të banesave, bashkelidhur po ju dërgojmë projekt vendimin "Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë në tregun e lirë për vitin 2024, për familjet që përfitojnë subvencionin e qirasë në tregun e lirë, sipas strukturave përkatëse të banesave".

Konceptoi:
Specialist Strehimit Social
Edmond Gjeçaj

Miratoi:
Përgjegjëse Sektori Strehimit Social
Bleona Shimaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA E MBROJTJES, PËRFSHIRJES DHE STREHIMIT SOCIAL
SEKTORI I STREHIMIT SOCIAL

Nr. _____ Prot.

Vau-Dejes, më 14/6 / 2024

Lënda: Informacion për ngritjen e grupit të punës për nxjerrjen e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë në tregun e lirë, për familjet që përfitojnë subvencionin e qirasë në tregun e lirë, sipas strukturave përkatëse të banesave.

Drejtuar: Kryetarit të Bashkisë Vau-Dejës

Z.Kristian Shkreli

Bazuar në testimet e kryera në tregun e lirë Bashkine Vau Dejës, të dhënat e marra nga përfituesit dhe aplikuesit për programin e strehimit "Subvencioni i qirasë në tregun e lirë", gjithashtu bazuar dhe në vlerat e vitit të mëparshëm për vlerën maksimale të subvencionit të qirasë.

Grupi i punës i ngritur me urdhër të brendshëm 414 datë 11.06.2024 i përbërë nga:

- Bleona Shimaj
- Klevisa Bisha
- Edmond Gjeçaj

"Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë në tregun e lirë, për familjet që përfitojnë subvencionin e qirasë në tregun e lirë, sipas strukturave përkatëse të apartamenteve"
Sipas nenit 2 pika 36, të ligjit nr. 22/2018 datë 3.5.2018, i ndryshuar "Qira mesatare" është mesatarja e ofertave të qirave, të marra gjatë një viti, në tregun e lirë.

Qira reale, është vlera aktuale e çmimit të qirasë së një banesë të caktuar në tregun e lirë.

Sa më lart, nevojitet përcaktimi i vlerave të qirasë mesatare të tregut të lire gjatë vitit 2024 për Njësin Administrative Vau Dejës qendër dhe njësitë administrative Bushat, Hajmel, Vig Mnelë, Temal, Shllak. Për efekt të përcaktimit të vlerave të qirasë mesatare, grupi i punës, në bashkëpunim me kryetarët e njësive administrative, ka kryer teste të shumta në terren, në



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS

banesat e dhëna me qira për banim. Nga studimi është konstatuar mungesa e banesave me qira në njësitë administrative Hajmel, Vig Mnelë Temal dhe Shllak.

Në bazë të dhënave që kemi mbledhur bashkinë e kemi ndarë në tre kategori:

1. Apartamente dhe shtëpia private që shtrihen përgjatë rrugëve kryesore në lagjet-qendër të qytetit.
2. Apartamentet dhe shtëpia private që ndodhen në lagjet periferike dhe fshatrat përreth.
3. Shtëpia private që janë të pozicionuara në fshatrat afër zonës së hidrocentralit si Spathari dhe Ashta.

Kemi mbledhur të dhëna për tre kategoritë duke kryer sondazhe për çdo tipologji banimi : apartament (1+1) dhe (2+1) dhe shtëpi private (2+1) dhe (3+1). Nga studimi në terren vërehet mungesa e apartamenteve (3+1). Vlerat me të cilat ofrohen objektet me qira me funksion banimi në tregun e lirë, e ndarë sipas njësive administrative luhaten si vijon:

Njësia Administrative Vau-Dejës

Apartament (1+1)	10 000-12 000 lekë/muaj, mesatare 11 000 lekë
Apartament (2+1)	15 000-18 000 lekë/muaj, mesatare 16 500 lekë
Shtëpi private (2+1)	20 000-22 000 lekë/muaj, mesatare 21 000 lekë
Shtëpi private (3+1)	22 000-25 000 lekë/muaj, mesatare 23 500 lekë

Njësia Administrative Bushat

Apartament (1+1)	13 000-15 000 lekë/muaj, mesatare 14 000 lekë
Apartament (2+1)	15 000-18 000 lekë/muaj, mesatare 16 500 lekë
Shtëpi private (2+1)	20 000-22 000 lekë/muaj, mesatare 21 000 lekë
Shtëpi private (3+1)	22 000-25 000 lekë/muaj, mesatare 23 500 lekë

Në përfundim konfirmojmë se, vlerat maksimale të subvencionimit të qirasë, për rastet kur qiraja do të subvencionohet në masën 100% të vlerave të qirasë mesatare mujore, nga Bashkia Vau Dejës, për vitin në vijim, të jenë:

Adresa, Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës nr. Tel: Telefon/Faks 00355 2612 0006, e-mail e-mail: info@vaudejës.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS

Apartament (1+1)	12 500 lekë/muaj
Apartament (2+1)	15 500 lekë/muaj
Shtëpi private (2+1)	21 000 lekë/muaj
Shtëpi private (3+1)	23 500 lekë/muaj

Në rast se do të kemi kërkesa në njësit Hajmel, Temal, Shllak dhe Vig Mnelë, këto raste do të trajtohen sipas vlerave maksimale te subvencionimit të qirasë si më sipër.

Grupi i punës:

Përgjegjëse Sektori i Strehimit Social
Bleona Shimaj

Specialist Sektori i Strehimit Social
Klevisa Bisha

Specialist Sektori i Strehimit Social
Edmond Gjeçaj